



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorëzuar Priljeno / Prodato Received / Delivery		18.04.2023 viti god year	
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KM/HA	3635/2023		1/8



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A02/245/2016

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari anëtare, me Kaltrina Avdullahu-Prenaj, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktvendimit ARJ-UZVP.nr.134/2022 të datës 27.12.2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës, ka rishqyrtuar ankesën me numër A02/245/2016 të datës 02.09.2016 të parashtruar nga ankuesja

, kundër organit të punësimit/Gjykata Themelore në Gjilan, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.04.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A02/245/2016 e datës 02.09.2016 e parashtruar nga ankuesja
- II. **Anulohet** procedura e rekrutimit e shpallur sipas Konkursit me numër reference Nr.15/2015 i datës 26.02.2016 për pozitën “Administrator” në Gjykatën Themelore në Gjilan.
- III. **Shfuqizohet** Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, Akt Emërimi për kandidaten \_\_\_\_\_ si dhe të gjitha aktet tjera që rrjedhin nga kjo procedurë e rekrutimit.
- IV. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për zbatimin e këtij vendimi në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 02.09.2016 ka marr vendim me A/02/245/2016, me numër protokoll 3645/2016, me të cilin e ka refuzuar ankesën e



ankueses duke e lënë në fuqi Vendimin me numër KA 3/16 të datës 17.05.2016, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjilan.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me numër nr. A/02/245/2016 të datës 02.09.2016, të nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 05.10.2016, ka hapur konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamentit për Çështje Administrative, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 05.09.2018 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1531/16 me të cilin e ka aprovuar kërkesë padinë e paditëses si të bazuar dhe e ka anuluar Vendimin me numër A/02/245/2016 me numër protokoll 3645/2016 të datës 02.09.2016 të nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrjes për Shërbimin Civil të Kosovës sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1531/16 të datës 05.09.2018 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, ka rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.02/254/2016 të datës 20.06.2016 të parashtruar nga ankuesja kundër organit të punësimit Gjykata Themelore në Gjilan në çështjen juridike "kontestim konkursi" dhe me datën 04.12.2018 merr vendim me numër A.nr.719/2018 me të cilin e shfuqizon Vendimin me numër KA 3/16 të datës 17.05.2016 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjilan dhe lëndën e ankueses e kthen në rishqyrtim tek organi i njëjtë.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave në Gjykatën Themelore në Gjilan, sipas Vendimit me numër A.nr.719/2018 të datës 04.12.2018, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrjes për Shërbimin Civil të Kosovës e rishqyrton ankesën e ankueses dhe me datë 19.12.2019 nxjerr vendim me të cilin e refuzon ankesën e ankueses se datës 13.05.2016 dhe e lenë në fuqi raportin përmbledhës të datës 14.04.2016 për pozitën "Administrator" në Gjykatën Themelore në Gjilan, ndërsa ankuesja e pakënaqur me Vendimin e datës 19.12.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Gjykatës Themelore në Gjilan, me date 24.12.2018 parashtron ankese me numër protokoll 7909/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrjes për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankueses ndërsa më datë 07.02.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kurse pala ankuese me datë 11.02.2019 ka hapur konflikt administrativ sipas këshillës së dhënë juridike.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative sipas kërkesës së datës 17.12.2018 të palës së interesuar për rishikim të Aktgjykimit të datës 05.09.2018 me numër A.nr.1531/16 me datë 12.04.2019 ka nxjerr Aktgjykim me numër A. Nr. 1531/16 me të cilin aktgjykim e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar dhe e ka anuluar Vendimin me numër A/02/245/2016 me numër protokoll 3645/2016 të datës 02.09.2016, të nxjerr nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje në Këshill.



Në cilësinë e palës së interesuar, me datë 25.06.2019 kundër Aktgjykimit me numër A. nr.531/16 të datë 12.04.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, ndërsa Gjykata e Apelit të Kosovës me datë 14.01.2021, ka aprovuar si të bazuar në ligj ankesën e palës së interesuar duke e anuluar Aktgjykimin A. nr.531/16 të datë 12.04.2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 12.04.2019 dhe lenden e kthehen në gjykatën e shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 30.04.2021, sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në rishqyrtim dhe rivendosje, e aprovon ankesën e ankueses dhe anulon vendimin e Këshillit të datës 02.09.2016, ndërsa pala e interesuar e pakënaqur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 30.04.2021, me datë 11.06.2021 ka parashtruar ankesë tek Gjykata e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 30.04.2021.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me datë 16.06.2021, me numër protokollit 3131/2021, kundër Aktgjykimit të datës 30.04.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 16.06.2021, ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit.

Ndërkohë, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me datë 08.12.2021 nxjerrë Aktgjykimin A.nr.389/19 dhe i aprovon kërkesë padinë e paditëses për shkak të mos shqyrtimit të ankesës së ankueses duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses 24.12.2018.

Pasi që kundër Aktgjykimit me numër A.nr. 1531/16, të datës 30.04.2021 janë parashtruar dy ankesa në Gjykatën e Apelit, respektivisht nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës dhe pala e interesuar dhe përderisa lënda është duke u trajtuar në Gjykatën e Apelit të Kosovës për të njëjtin objekt shqyrtimi, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në kuptim të nenit 85 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me date 17.01.2022 Pezullon procedurën administrative të nisur sipas ankesës me numër A.nr. 847/2018 të datës 24.12.2018, të parashtruar nga ankuesja sipas Aktgjykimit me numër A.Nr.389/2019, të datës 08.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative .

Gjykata e Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative me datë 06.10.2022 nxjerrë Aktgjykimin AA.nr.854/2021, përmes të cilit e refuzon ankesën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe palës së interesuar duke e vërtetuar Aktgjykimin A. Nr. 1531/2016, të datës 30.04.2021 Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kurse Këshilli me datë 31.10.2022 kundër Aktgjykimit AA.nr.854/2021 të Gjykata e Apelit të Kosovës, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në Gjykatën Supreme të Kosovës, ndërsa me datë 27.12.2022 Gjykata Supreme e Kosovës mori Aktvendim ARJ-UZVP.nr.134/2022 përmes të cilit kërkesën e Këshillit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm si dhe kërkesën e palës së interesuar ndaj Aktgjykimit AA.nr.854/2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës i hedhë poshtë si të palejuar,



ndërsa e vërteton Aktgjykimit AA.nr.854/2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti për Çështje Administrative të datës 06.10.2022.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesa e datës 20.06.2016, Nr. 02/245/2016 drejtuar Këshillit; Vendimi i datës 19.05.2016, me numër protokolli K.A 3/16, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesa e datës 13.05.2016, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vërtetimi i datës 03.03.2016, nr. 100/2016; renditja përfundimtare e kandidatëve; e- maili i datës 06.04.2016; e- maili i datës 18.04.2016; parashtrere e datës 06.04.2016; Autorizimin nga DASHC/MAP për shpalljen e konkursit i datës 23.02.2016; Konkursi i datës 26.02.2016; Akt emërimet e anëtareve të Komisionit përzgjedhës; Akt Emërimi i datës 31.12.2012, referencë 112-1401; Akt Emërimi i datës 31.12.2012, reference 112-1421; Akt Emërimi i datës 28.12.2012, reference 112- 606; Akt Emërimi i datës 05.02.2013, reference 97/2013; Vendimin me numër 138/2016 i datës 12.04.2016 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Regjistrin e Aplikacioneve të pranuarat të datës 08.04.2016; e- maili i datës 12.04.2016, nga Drejtori i Administratës së Përgjithshëm i S-KGJKSK-së drejtuar Këshillit; Njoftimin me numër 146/2016 të datës 18.04.2016 për kandidatin e suksesshëm; Raporti i KPSHC, i datës 08.04.2016; Formularin për përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testin me shkrim për kandidatin e përzgjedhur dhe ankuesen e datës 12.04.2016; Raporti përmbledhës i datës 14.04.2016; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 14.04.2016; kërkesa për punësim e \_\_\_\_\_, me shkresat e bashkangjitura; diplomë nr. 1816 e datës 14.04.2008; rekomandimi i datës 10.03.2016, Nr. 03/86; vërtetimi i datës 28.01.2016, Nr.03/42; certifikatë e datës 08.02.2005; rekomandim e datës 31.03.2009; vërtetim i datës 29.10.2007, me numër protokolli 1292/07; vërtetimi i datës 31.03.2009, nr. 92; vërtetimi i datës 27.01.2016, Nr. 03/41; certifikatë e datës 09.07.2004, NR. 02-204/I; kërkesa për punësim për \_\_\_\_\_ me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e datës 24.09.2003; diplomë e datës nr. 252, e datës 28.03.2012; Certifikatë e datës 3-4 shkurt 2015; Certifikatë e datës 23-24 shkurt 2016; Vërtetimi i datës 03.03.2016, Nr. 100/2016; Referencë e datës 04.03.2016; Rekomandim i datës 11.03.2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në Punë; Vendimi i datës 29.07.2015; shkresën elektronike (e-mailin) e datës 01.04.2016 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_; shkresën elektronike (e-mailin) e datës 05.04.2016 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_; Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 04.04.2016 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_; Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 04.04.2016 nga \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_ dhe \_\_\_\_\_ përgjigje në Ankesë e datës 07.07.2016 me numër protokolli 2806/2016 me shkresat e bashkangjitura 1/105; Aktgjykimi i datës 05.09.2018 A. Nr. 1531/2016, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, i pranuar në Këshill me datë 06.11.2018; Aktgjykimi A. Nr. 389/19, datës 08.12.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Ankesa e datës 24.12.2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërtetim i datës 03.03.2016; Vendimi i datës 06.12.2018. A. Nr. 719/2018, Ankesa e datës 24.12.2018, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 19.12.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Aktvendimi i datës 29.06.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; Padi e datës 11.02.2019, drejtua Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; Konkursi i datës 26.02.2016; Certifikatë e datës 24.09.2003, për ankuesen \_\_\_\_\_ Diplomë e datës 10.11.2011 për ankuesen \_\_\_\_\_ Ankesë e datës 11.06.2021, drejtuar Gjykatës së Apelit, nëpërmjet Gjykatës Themelore në Prishtinë; Ankesë e datës 16.06.2011, e Këshillit drejtuar Gjykatës së Apelit në



Prishtinë; Aktgjykimi A. Nr. 1531/16, i datës 30.04.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; Aktvendimi A. A. Nr, 401/2019, i Gjykatës së Apelit të Kosovës/Departamenti për Çështje Administrative; Ankesë e datës 25.06.2019, drejtuar Gjykatës së Apelit, nëpërmjet Gjykatës Themelore në Prishtinë; Aktgjykimi A. Nr. 1531/16, i datës 12.04.2019, i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative; njoftimi i datës 07.02.2019, i Këshillit; Kërkesë e datës 20.12.2018, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; vendimi i datës 05.09.2016, A. Nr. 02/298/2016, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopje e kërkesës e datës 11.01.2019, Gjykata Kushtetuese e Kosovës; E- maili i datës 27.12.2018; Prova shtesës e datës 26.12.2018, Drejtuar Këshillit; Përgjigje në padi e datës 31.05.2018, e Këshillit drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative; Padia e datës 05.10.2016, drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative; Vendimi i datës 02.09.2016, A. Nr. 02/245/2016, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 20.06.2016, Nr. 02/245/2016, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 19.05.2016, me numër protokoll K.A 3/16, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesa e datës 13.05.2016, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vërtetimi i datës 03.03.2016, nr. 100/2016; renditja përfundimtare e kandidatëve; e- maili i datës 06.04.2016; e- maili i datës 18.04.2016; parashtrësë e datës 06.04.2016; Autorizimin nga DASHC/MAP për shpalljen e konkursit i datës 23.02.2016; konkursi i datës 26.02.2016; Akt emërimet e komisionit përzgjedhës; Akt Emërimi i datës 31.12.2012, reference 112-1401; Akt Emërimi i datës 31.12.2012, reference 112-1421; Akt Emërimi i datës 28.12.2012, reference 112- 606; Akt Emërimi i datës 05.02.2013, reference 97/2013; Vendimin me numër 138/2016 i datës 12.04.2016 për emërimin e Komisionit Përzgjedhës të Shërbimit Civil; Regjistrin e Aplikacioneve të pranuarat të datës 08.04.2016; e- maili i datës 12.04.2016, nga Drejtori i Administratës së Përgjithshëm i S-KGJKSK-së drejtuar Këshillit; Njoftimin me numër 146/2016 të datës 18.04.2016 për kandidatin e suksesshëm; Raporti i KPSHC, i datës 08.04.2016; Formularin për përcaktimin e kriterëve për testim me shkrim dhe me gojë për vendin e punës për të cilin nuk kërkohet njohja e ndonjë gjuhe të huaj; Testin me shkrim për kandidatin e përzgjedhur dhe ankuesen e datës 12.04.2016; Raporti përmbledhës i datës 14.04.2016; Raporti Final i Rekomandimit nga Komisioni Rekrutues i datës 14.04.2016; kërkesa për punësim e me shkresat e bashkangjitura; diplomë nr. 1816 e datës 14.04.2008; rekomandimi i datës 10.03.2016, Nr. 03/86; vërtetimi i datës 28.01.2016, Nr.03/42; certifikatë e datës 08.02.2005; rekomandim e datës 31.03.2009; vërtetim i datës 29.10.2007, me numër protokoll 1292/07; vërtetimi i datës 31.03.2009, nr. 92; vërtetimi i datës 27.01.2016, Nr. 03/41; certifikatë e datës 09.07.2004, NR. 02-204/I; diplomë e datës 14.07.2008; kërkesa për punësim për me shkresat e bashkangjitura; Certifikatë e datës 24.09.2003; diplomë e datës nr. 252, e datës 28.03.2012; Certifikatë e datës 3-4 shkurt 2015; Certifikatë e datës 23-24 shkurt 2016; Vërtetimi i datës 03.03.2016, Nr. 100/2016; Referencë e datës 04.03.2016; Rekomandim i datës 11.03.2016; Formulari për vlerësimin e rezultateve në Punë; Vendimi i datës 29.07.2015; shkresën elektronike (e-mailin) e datës 01.04.2016 nga për dhe ) shkresën elektronike (e-mailin) e datës 05.04.2016 nga për Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 04.04.2016 nga për dhe ; Shkresën elektronike (e-mailin) e datës 04.04.2016 nga për dhe ; përgjigje në Ankese e datës 11.07.2016 me numër protokoll 2806/2016 me shkresat e bashkangjitura 1/105; Kërkesën e Këshillit drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës e datës 31.10.2022; Aktvendim ARJ-UZVP.nr.134/2022 të



Gjykata Supreme e Kosovës i datës 27.12.2022; Aktgjykimin AA.nr.854/202 e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative i datës 06.10.2022; Aktgjykimin AA.nr.1531/16 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 30.04.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për rivendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë si dhe duke marrë për bazë pikëpamjet juridike sipas Aktvendimit ARJ-UZVP.nr.134/2022 të Gjykatës Supreme të Kosovës, Aktgjykimit AA.nr.854/2022 e Gjykatës së Apelit të Kosovës-Departamenti për Çështje Administrative i datës 06.10.2022 si dhe Aktgjykimit A.nr.1531/16 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 30.04.2021 ka konstatuar se ankesa e ankueses është e *bazuar*, sepse:

Kolegji i Këshillit nga shkresat e administruara të lëndës ka gjetur se Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës pas aprovimit të marr nga DASHC-Ministria e Administratës Publike me shkresën e datës 22.02.2016, ka shpallur konkursin e jashtëm me numër reference Nr. 15/2015, në gazetën "Zëri" për pozitën e lirë të punës "Administrator" në Gjykatën Themelore në Gjilan me datën 26.02.2016, ndërsa kriteret e përcaktuara të konkursit kanë qenë:

- *Diplomë Universitare, Shtatë (7) vjet përvojë pune profesionale, duke përfshirë katër (4) vjet përvojë pune në vende udhëheqëse".*

Po ashtu, nga shkresat e administruara të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se pas përfundimit të procedurës së rekrutimit për pozitën "Administrator" në Gjykatën Themelore në Gjilan, sipas Njoftimit me shifër: GJ.A-Su.A146/2016 të datës 18.04.2016 kandidatë e pazgjedhur rezultojnë të jetë kandidatja

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses nëse procedura e rekrutimit është zhvilluar në pajtueshmëri me nenin 11 dhe 18 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit ka analizuar dosjen e kandidatës së përzgjedhur znj. dhe ka gjetur se e njëjta posedon Diplomën Nr.1816 të datës 14.07.2008 me të cilën dëshmohet se ka kryer Fakultetin Juridik në Universitetin e Prishtinës duke marrë titullin "Jurist i Diplomuar", ndërsa sipas vërtetimit Nr.03/42 të datës 28.01.2016 dëshmohet se e njëjta prej datës 03.09.2007-31.08.2008 ka punuar si Arsimitare e Gjuhës Angleze në Shkollën Fillore "Thimi Mitko", prej datës 01.09.2008 deri më datë 31.03.2009 profesoreshë e gjuhës angleze në Shkollën e Mjekësisë "Dr. Asllan Elezi" në Gjilan, ndërsa sipas Rekomandimit me numër:03/86 e njëjta prej datës 24.08.2010 deri më datën e lëshimit të rekomandimit me datë 10.03.2016 ka punuar në pozitën Zëvendës Drejtor në Shkollën Fillore "Thimi Mitko" në Gjilan, prandaj në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, Komisioni Përzgjedhës me rastin e përfshirjes së kandidatës së përzgjedhur në listën e shkurtër, respektivisht përzgjedhjen e saj si kandidatë e suksesshme kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 28 paragrafit 1 nen paragrafit 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve si në vijim: 1.1arsimimi dhe kualifikimi profesional dhe 1.2 përvoja e punës"*, ngase përvoja e saj e punës prej më shumë se tre (3) vjeçare në cilësi të mësimdhënëses së gjuhës angleze, si dhe përvoja e punës mbi pesë (5) vjeçare në cilësi të Zv. Drejtor në Shkollën Fillore nuk mundet t'i llogaritet si përvojë e punës profesionale, ngase e njëjta është juriste e diplomuar dhe se lënda të cilën e ka ligjëruar gjatë procesit mësimdhënës nuk hynë në fushën e përgjithshme të Fakultetit Juridik gjegjësisht në



fushën e drejtësisë, sikurse nga shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se konkursi i kontestuar është shpallur i jashtëm, veprim ky i cili ua mohon të drejtën nëpunësve civil ekzistues për avancim në karrierë, andaj ky veprim procedural është në kundërshtim me nenin 18 paragrafi 5 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankesa A02/245/2016 e datës 20.06.2016 e ankueses

është e bazuar, pasi që përvoja e punës profesionale është e lidhur ngushtë me profesionin apo titullin e fituar përmes diplomimit sikurse institucioni punëdhënës ka zbatuar gabimisht dispozitat e nenit 18 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.

Prandaj, nisur si më lartë, meqenëse janë gjetur dhe konstatuar shkelje të dispozitave të ligjit material, ngase ankuesja nuk e kishte plotësuar njërin nga kushtet apo kriteret e konkursit të datës 26.02.2016 lidhur me përvojën e punës profesionale, me çka Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil kishte vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafit 1 nënparagrafi 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se procedurat e konkursit me numër reference Nr. 15/2015 për pozitën e punës "Administrator" në Gjykatën Themelore në Gjilan me datën 26.02.2016 sikurse edhe përzgjedhja e kandidatës fitues janë zhvilluar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil sikurse është përcaktuar me nenin 11 paragrafi 1 dhe nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: "11.1 Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve; 18.1 Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitive të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidateve dhe të drejtën për t'u ankuar në fund të procedurës" prandaj mbi këtë bazë sikurse duke marr parasysh edhe të gjeturat dhe vërejtjet e dhëna përmes dhe Aktgjykimit A.nr.1531/16 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 30.04.2021 përmes të cilit aktgjykim ishte anuluar Vendimi i Këshillit A02/245/2016 i datës 02.09.2016, Kolegji i Këshillit mori vendim si në dispozitiv që Njoftimi me shifër: GJ.A-Su.A146/2016 të datës 18.04.2016 dhe Akt Emërimi për emërimin e kandidatës së përzgjedhur të shfuqizohen, ndërsa procedura e konkursit të datës 26.02.2016 me numër reference Nr. 15/2015 për pozitën e punës "Administrator" në Gjykatën Themelore në Gjilan është anuluar.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda A.02/245/2016**



Kaltrina Avdullahi-Prenaj

  
Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Gjykatës Themelore në Gjilan, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

